



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË-SHERBIME

611-21-2552-2-1-1/C430

TITULLI : KUJDESI SOCIO-SHENDETESOR SHTEPIAK DHE AMBULATOR PER QYTETARET E KOMUNES SE DRENASIT – RITENDERIM

Numri identifikues: 611-21-019-211 R, nr. i arkivit : 02-400 – 26842 përgaditur ne Drenas: 186.06.2021

KOMUNA DRENAS. (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

" KosovaMed Healthcare " SH.P.K. KASTRIOT ASLLANI (drejtor) PRISHTINË, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

KUJDESI SOCIO-SHENDETESOR SHTEPIAK DHE AMBULATOR PER QYTETARET E KOMUNES SE DRENASIT - RITENDERIM me numër identifikues: 611-21-2552-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: KOMUNA DRENAS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 18.06.2021 dhe përfundon në datën 17.06.2024

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë menjëherë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë QKMF –KOMUNA E DRENAS-it .

[Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 372 600,00 Euro. (Treqindë e Shtatëdhjetë e Dymijë e Gjashtëqindë euro Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+/- 30%])

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët SHQIPE në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Shërbimet**" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2

Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3

Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihet lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do të lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoje një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatim i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblejë Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| | | |
|----------------------------------------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 1.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| Gjuha | 1.2 | Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha shqipe |
| Obligimet e Autoritetit Kontraktues | 1.3 | Autoriteti kontraktues merrë për obligim që kontraktuesit t'i sigurojë kushte duke ju siguruar zyrë të veçantë për vendosjen e personelit dhe të pasiveve deri sa të zgjatë kontratën si dhe kushtet e veçanta duke u bazuar në Dosjen e Tenderit dhe Projektin e KUJDESI SOCIO-SHENDETESOR SHTEPIAK DHE AMBULATOR PER QYTETARET E KOMUNES SE DRENASIT. |
| Programi i realizimit | 1.4 | Drejtoria E SHENDËTISIS nëpërmes Kryetarit të komunës obligohet që të caktojë Mbykqyesi I Drejtpërdrejtë dhe Menaxherin e projektit, të cilët duhet të hartojnë Plan të menaxhimit të kontratës konform nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për mbikqyrjen dhe raportimin për shërbimet e kryera. |
| Menaxhimi | 1.5 | Menaxheri i caktuar ka për obligim që OE shërbyes ta përcjellë realizimin e kontratës dhe kryerjen e shërbimeve,) ashtu si është precizuar në dosjen e tenderit dhe në Projektin KUJDESI SOCIO-SHENDETESOR SHTEPIAK DHE AMBULATOR PER QYTETARET E KOMUNES SE DRENASIT – RITENDERIM. |
| Obligimet e kontraktuesit | 1.6 | Kontraktuesi do t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, Ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje lidhur me nevojën për publikim ose shpallje për qëllime të kontratës, vendimi i Autoritetit kontraktues do të jetë final. Shërbimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkuara në dosje të tenderit. Nëse shërbimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përsëri janë të tilla, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet. |
| Siguria e ekzekutimit | 2.0 | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e shumës dhe do të jetë valid 37 muaj. Siguria e ekzekutimit duhet të ofrohet nga OE në ditën e hyrjes në kontratën në fuqi. Kontraktuesi duhet të përfundojë shërbimet sipas datës së paraparë në nenin paraprak në afat deri me 17.06.2024 dhe të dorëzojë raportin përfundimtar të shërbimeve të kryera në fund të çdo muaji ku duhet të përmbahen të gjitha detajet për shërbimet kryera. |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i | 2.1 | Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: sipas ligjeve në fuqi b) Përgjegjësia e pales së tretë sipas ligjeve në fuqi c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve sipas ligjeve në fuqi d) Përgjegjësia profesionale sipas ligjeve në fuqi |

| | | |
|----------------------------------------------------|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| shërbimit | | e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve sipas ligjeve në fuqi Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit që në bazë të kontratës i takojnë Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë <u>përgjegjësi të plotë</u> , dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Drejtoria për Shëndetsi nga ankesat dhe dëmet tjera të shkaktuara nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre. |
| Pagesat | 2.3 | Për t'i marrë pagesat, Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Autoritetit të përmendur në paragrafin 26.1 më lart: a) Kontraktuesi obligohet që për shërbimet e kryera në muajin e kaluar, Faturën ta dorëzojë nga data 01 deri 05 e muajit në vazhdim ose në <u>momentin e kryejrje së shërbimeve</u> . b) Paga nga Komuna duhet të kryhet mundësisht menjëherë, nëse jo atëherë jo më vonë se <u>tridhjetë ditë pas dorëzimit dhe pranimit të faturës</u> . Ndërsa nëse pagesat vonohen nga ana e Komunës për OE shërbyes, atëherë do të veprohet konform Ligjeve në fuqi për kompensime në vonesa në paga. |
| Kualiteti i Shërbimeve | 3.0 | Shërbimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkuara në dosje të tenderit. Nëse shërbimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përsëri janë të tilla, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet. |
| Dëmet e likuiduara | 3.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Mbykqyesi i Drejperdrejtë të Projektit Operatori Ekonomik futet në penale nëse shërbimet janë të dobëta edhe pas tërheqjes së vërejtjes nga Menaxherit. Nëse ka shërbime të dobëta dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim për mos futje në penale. |
| Monitorimi | 3.2 | Menaxherët e caktuar me vendim obligohen që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatën komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera. |
| Parapagimi | 4.0 | Shuma e parapagimit (avans) : 0 |
| Mbajtja e Parasë | 4.1 | Shuma e parave të mbajtura është: 0 % |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 5.0 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e shërbimeve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Shërbimeve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha shërbimet e kryera dhe të papaguara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 6.0 | Mundësishtë në mes të dy palëve. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 7.0 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. |
| Mbikëqyrja | 7.1 | Mbikëqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. |
| Shërbime shtesë | 7.2 | Shërbime shtesë mund të ketë konform kontratave kornizë + apo - 30 % të shumës së kontratës. |
| Pagesat | 7.3 | Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për shërbimet e kryera mujore. |

| | | |
|-------------------------------------|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dorëzimi i dokumenta ve Autoritetin | 7.4 | Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës , aktvendimet, procesverbalet, raportet, pranimet, urdhëresat, faturat, shkresat, etj. |
| Arkimi i dokumenta ve | 7.5 | Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimet, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. |
| Hyrja në fuqi | 8.0 | Kontrata hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve. Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale. |

Kontratës iu bashkangjiten keto dokumenta :
Paramasa dhe paralogaria si dhe projekti që do të zbatohet gjatë ofrimit të shërbimeve.

Për Palet Kontraktues

Emri: MENSUR GLLAREVA

Pozita: ZPP

Nënshkrimi:

Data:

Vula:



Emri: KASTRIOT ASLLANI

Pozita: DREJTOR

Nënshkrimi:

Data:

Vula:



Emri: RAMIZ LLADROVCI :

Pozita: KRYETAR KOMUNE

Nënshkrimi:

Data:

Vula:



Kujdesi paliativ-Vizitat në shtëpi për pacientet e palëvizshëm dhe me veshhtësi në qasje në IKPSSH. Pershkrim nga Statuti I QKMF dhe UA i MSH 04/2020

PARAMASA

| Nr. | Përshkrimi | Njësia matëse | Sasia per 36 muaj | Çmimi per njësi | Shuma | |
|-----|-------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------|-------|------------|
| 1 | Vizita Mjekësore | 1.1.Anamneza, Inspekcioni,egzaminimi 1.2.Kujdesi per sëmundjet kronike A. Respiratore b.Sistemit kardiovaskular c. Sistemit gastro intestinal d, Sistemitmuskulo skeletor e..Sistemi urogjenital f.Semundjet e sistemit nervor | VM NE TEREN | 26000 | 6.90 | 179,400.00 |
| | | 1.3.Rehabilitimi posttraumatik dhe pas 1.4. Largimi I dhimbjeve 1.5.Ordinimi I terapisë 1.6. Caktimi I glikemisë me glukometër 1.7 Këshillimi | VM NE KPSH | 20000 | 2.00 | 40,000.00 |
| 2 | Shërbime Mjekësore | 2.1. Dhënja e injeksionit S. C. 2.2. Dhënia e injeksionit I.M. 2.3. Dhënja e injeksionit I.V. 2.4. Dhënja e infuzionit 2.5. Pastrimi I plagës postoperative 2.6. Pastrimi I plagës postoperative 2.7. Trajtimi shputes diabetike 2.8 Trajtimi I dekubitusit 2.9. Ndrrimi I kateterit urinar 2.10.Heqja e penjëve 2.11. Pastrimi I veshëve 2.12. Marrja gjakut për analiza Lab. | Sherbim ne teren | 30000 | 2.00 | 60,000.00 |
| | | | Sherbim ne KPSH | 28200 | 1.00 | 28,200.00 |
| 3 | Vizitat mjekësore të shendetit oral-Stomatologu | 3.1.Anamneza, inspekcioni, Egzaminimi objektiv 3.2.Ordinimi I terapisë 3.3 Këshillimi | VM NE TEREN | 3000 | 6.50 | 19,500.00 |
| | | 4.1.Pastrimi I dhëmbëve 4.2. Sherimi 4.3.Kiretazha 4.4.Ekstrakcioni I dhëmbit 4.5. Ordinimi I terapisë 4.6. Vizitat sistematike të fëmijëve 4.7. Edukimi për higjenën e gojes dhe dhëmbëve | VM NE KPSH | 4500 | 2.00 | 9,000.00 |
| | | 5.1.Asistimi gjatë VM te stomatologut 5.2.Hartimi I planit të procedurave 5.3.Dezinfektimi në menyre të pamvarur I vendit të punës. 5.4.Pergaditja dhe perkujdesja ndaj mjeteve | Sherbime dentare | 5000 | 4.00 | 20,000.00 |

| | | | | | | |
|---|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|----------|------|------------|
| 4 | Shërbime Mjekësore dentare | 5.5. Sterilizimi i instrumenteve | ne teren | | | |
| | | 5.6. Perzierja e materialit për mbushje të | | | | |
| | | 5.7. Kalimi i paisjeve të dentist | | | | |
| | | 5.8. Informimi i përdorues të shërbimeve | | | | |
| | | 5.9. Ndihmon pacientet me nevojë të veçanta (fëmijet, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara) me procedurë terapeutike | Sherbime dentare ne KPSH | 4000 | 3.00 | 12,000.00 |
| | | 5.10. Zbatimi i vizitave sistematike për fëmijet parashkollor dhe shkollor në ekip për higjienë të gojës dhe dhëmbëve në bazë të planit të veprimit. | | | | |
| 5 | Shërbimet sociale | Shërbimet sociale për personat me regjim shtëpiak, do të përfshijnë Përmirësim i kushteve jetësore në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm, duke ndihmuar në mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit të brendshëm të shtëpisë tek personat e moshuar të vetmuar pa përkujdes familjar. Mundësi për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet shoqërore përmes kontaktit me ta dhe me shërbime specifike psiko-sociale për rastet e veçanta, bashkëbisedim, komunikim me pacientët etj. | Sherbim | 1,000.00 | 4.50 | 4,500.00 |
| | | | | | | 372,600.00 |

Kerkesa specifike:

Vizita Mjekësore: Përfshinë të gjitha aktivitetet e shënuara në nr. Rendor 1 dhe 3

Shërbimi Mjekësor: Secili emërtim është aktivitet në vete

Evidencimi i pacientave: Mjekët dhe infermierët janë të obliguar që të regjistrojnë punën e tyre (VM & SHSH) në SISH - Web Aplikacion

Komisioni për hartimin e paramasës:

1 Dr. Florije Hoxha _____

2 Dr. Avni kastrati _____

3 Ardita Leku _____

7

SHËNIM

Pjesa C: - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Për: [KOMUNA GLLOGOC /
(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: [KUJDESI SOCIO-SHENDETESOR SHTEPIAK DHE AMBULATOR PER
QYTETARET E KOMUNES SE DRENASIT-RITENDERIM /


Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: <611-21-2552-2-1-1>. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

[Nëse objekti i kontratës është i ndarë në pjesë]
[shëno përshkrimin e mallrave]


[Nëse objekti i kontratës është i ndarë në pjesë]:
Pjesa nr [shëno numrin e Pjesës]: [shëno përshkrimin e mallrave]
Pjesa nr [shëno numrin e Pjesës]: [shëno përshkrimin e mallrave] ...
3. Çmimi total i tenderit është:

[Nëse objekti i kontratës nuk është i ndarë në pjesë]
Çmimi i tenderit në shifra: [372.600,00 €]
Dhe në fjalë [Tre/Shtate/Dy/Gjashtë/Zero/Zero/zero/zero Euro]
[Nëse objekti i kontratës është i ndarë në pjesë]:
Pjesa nr [shëno numrin e Pjesës]: [shëno çmimin e tenderit për pjesë, në shifra dhe fjalë]
Pjesa nr [shëno numrin e Pjesës]: [shëno çmimin e tenderit për pjesë, në shifra dhe fjalë] ...



4. Ky tender është valid për një periudhë prej [90 ditëve] nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës | 10% e vleres se kontrates ne kohezgjatje per 37 muaj].
6. Operatori Ekonomik [dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: [KOSOVAR]
7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet], me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

[Në rast të konsorciumit]




PROJEKT

TITULLI I PROJEKTIT

**Kujdesi Socio-Shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e
Komunës së Drenasit**

Prill 2021



Projekti:

Bazuar në :

Planin Komunal për Zhvillim Institucional të Kujdesit Parësor Shendetësor 2020-2024

Aktiviteti 1.2.4: Blerja e shërbimeve për personel shëndetësor përmes bashkëfinancimit me ndonjë OJQ apo OE dhe Komunës së Drenasit për vitin 2021 (5 Mjekë, 10 Inermierë dhe 2 shoferë) dhe

Aktiviteti 1.12.3: Fuqizimi i shërbimeve shëndetësore për 30% të personave të moshuar, personave me aftësi të kufizuara si dhe atyre në fazën terminale të sëmundjes, përmes shërbimit të kujdesit shtëpiak si dhe shërbimeve të kontraktuara për këtë qëllim.

Hartohet Projekti me titull:

“Kujdesi Socio-Shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Drenasit”

PIKAT KYCE TË PROJEKIT

- OE do të ofrojë stafin adekuat për ofrimin e shërbimeve shendetesore dhe shëndetit orale ne institucionet KPSH ku ka nevojë me theks të veçantë shërbimeve shëndetësore ne shtëpi
- OE rekomandohet të angazhojë ne projekt minimum: 17 punetorë, (4- Mjekë, 1- Stomatolog , 1- Laborant dentarë asist. I stomatologut, 9 -Inermierë dhe 2- shoferë)
Punetorët Shëndetësorë :Doktor të mjekësisë, Stomatolog , Infermier-laborant dentarë asist. , Infermier shëndetësor, Shofer. Ndarja e tyre duhet te behet ne disa grupe si dhe te perzgjedhet përgjegjësi i punetorve qe do te organizonte punën e përditshme. Secili punëtor i angazhuar duhet te kete dosjen personale me dokumentacionin valid: Dokument identifikimi, dokument qe nuk eshte nen hetime apo i dënuar per vepra penale, diplomën, licensen e punës profesionale, CV personale dhe kontratën e punës te cilat duhet prezantohen te QKMF-së dhe palëve tjera te interesuara.
- Që në baza të rregullta t'i ofrojë asistencë teknike stafit ekzistues në kuadër të DSHMS Drenas, në punët e tyre të përditshme
- Me pëlqim të DSHMS të komunës së Drenasit mund të organizohen fushata të promovimit, edukimit shëndetësor etj sidoms tek grupet vulnerable të popullatës në rastin e paraqitjes së epidemive të ndryshme.,semundejeve ngjitëse, shëndetit oral etj.
- Që në baza tre mujore t'i ofrojë QKMF-së - DSHMS raportin e punës me aktivitete te shërbimeve si dhe raportin vjetor.
- Raporti financiar do te dorëzohet gjdo vit ne QKMF dhe DSHMS- Drenas
- Të mundësojë realizmin e shërbimeve tjera deficitare shëndetësore për komunën e Drenasit

- **Shërbimet e kujdesit shëndetësor ambulator dhe shtëpiak** të ofruara nga mjeku i përgjithshëm brenda institucioneve komunale shëndetësore dhe në shtëpi të perfituesit, si vizitë mjekësore, do të përfshijnë:
Vizitë mjekësore, marrja e anamnezës, shikimi i dokumentacionit mjekësor ekzistues të pacientit, ekzaminimi i pacientit, matja e tensionit arterial dhe parametrave të tjere vital, përcaktimi i diagnozës, vendosja e menaxhimit të terapisë, edukimi shëndetësor, vendosja e planit të mjekimit, përcjellja e gjendjes shëndetësore, menaxhimi i terapisë, edukimi shëndetësorë, përcjellja e gjendjes shëndetësore të pacientit dhe varesishte nga nevoja referimi për në nivelin dytesorë e tretesorë
- **Shërbimet infermierore të kujdesit shëndetësor** vetëm në shtëpi të perfituesit do të përfshijnë: Përgatitja e pacientit për vizitë mjekësore, matja e shenjave vitale, aplikimi i terapisë orale, dhe parenterale, pastrimi dhe lidhja e plageve, vendosja dhe ndërrimi i kateterëve urinar, oksigjenoterapia, edukimi shëndetësor, ushtrimet pasive dhe aktive si preventive për dekubite, si dhe të gjitha shërbimet tjera infermierike, dokumentimi, etj
- **Shërbime stomatologjike**, për pacientët në ambulanta, vizita stomatologjike për të moshuar, të vetmuar, për nxënës në shkolla, etj.
- **Shërbime dhe detyrat e Doktorit – stomatolog:**

Ofron shërbime stomatologjike duke marrë masën e protezave totale dhe parciale si dhe ribazimin e tyre;

Kujdeset për mjetet e punës dhe materialit;

Zbaton dhe përdorë drejt masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;

I përmbahet etikës mjekësore;

Kryen plotësimin adekuat të dokumentacionit;

Kryen punën e reparaturave të dhëmbëve dhe korrekturave;

Avanson dhe promovon kujdesin/shëndetin Oral;

Bashkëpunon me ekipet e Mjekësisë Familjare dhe strukturat tjera relevante në përmirësimin e kujdesit/shëndetit oral;

Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Shefit të Sektorit të Shëndetit Oral

- **Shërbimet dhe detyrat e Laborantit dentar – asistentit të Stomatologjisë:** Koordinon-Asiston në punën e mjekut stomatolog në Ordinanca Stomatologjike në kuadrin e Sektorit të Shëndetit Oral;

Bashkëpunon me mjekun në promovimin e shëndetit oral, në kuadrin e Sektorit të Shëndetit Oral;

Kujdeset për instrumentet dhe sterilizimin e tyre;

Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;


Asiston gjatë punës së Stomatologut;

Bashkëpunon me Kryeinfermierin e Sektorit të Shëndetit Oral;

Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Kryeinfermierit të Sektorit të Shëndetit Oral;

Për punën e vet i përgjigjet Shefit të Sektorit të Shëndetit Oral

- **Shërbime infermierore ambulatorë të realizuara në QKMF, AMF, të pacientet:** Përgatitja e pacientit për vizitë mjekësore, matja e shenjave vitale, aplikimi i terapisë orale, dhe parenterale, pastrimi dhe lidhja e plageve, vendosja dhe ndërrimi i kateterëve urinar, oksigjenoterapia, edukimi shëndetësor, ushtrimet pasive dhe aktive si preventive për dekubite, dokumentimi, dhënjë e injeksioneve, vendosja e infuzioneve, etj.
- **Marrja e gjakut për analiza**, ruajtja dhe transporti deri në laborator, përpunimi i tyre dhe dorëzimi i rezultateve, për personat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut.



- **Shërbimet sociale** do të përfshijnë kujdesin social dhe higjeno-sanitar për persona në moshë, të semuar dhe të vetmuar: Përmirësim i kushteve jetësore në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm, duke ndihmuar në mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit të brendshëm të shtëpisë tek personat e moshuar të vetmuar pa përkujdes familjar. Mundësi për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet shoqërore përmes kontaktit me ta. Asistim në përgatitjen e dokumenteve për skema të ndihmes sociale, asistim të moshuarve dhe rasteve tjera sociale në QPS, për përgatitje të dokumenteve dhe aplikim në procedura të ndryshme sociale pranë QPS, etj.
- **Shpenzimet operative do të përfshijnë:** Mjetet e punës: (Pajisjet elementare mjekësore Tensiometer, Ultrasonografi kolordoplera, stetoskop, termometer, otoskop, aftalmoskop, pulsoximeter, karrigë stomatologjike, Kompjuter, Qanta për stafin, Uniforma, pastaj materialet elementare mjekësore (barëra e materiale shpenzuese mjekësore), material higjienik, shpenzime administrative të operatorit për implementim të projektit. Trajnimet e rregullta për stafin në kuadër të programit Kujdesi i Vazhdueshëm Profesional, i cili është si kusht për rilicencim. Automjet-Veturë (me 5 ulëse) për ekipet në teren. Vetura do të jetë obligim i OE. Pronar i Veturës duhet të jetë OE i cili duhet të marrë përsipër regjistrimin çdo vit, mirëmbajtjen, dhe furnizimi me karborante.
- **Infrastruktura:** Sigurohet nga QKMF

Kërkesa Detale për Operatorin Ekonomik:- Duhet të ketë në dispozicion mjetet dhe materialin mjekësorë për realizimin e shërbimeve mjekësore.

• Furnizimi me mallra, shërbime dhe pajisje & mjetet për implementimin e projektit:

1. **Furnizimet me mat. Adm/shend:** Udhëzime, Reçeta për terapi Orale dhe parenterale, Fletëza kompjuterike, Pasqyra laboratorike, Ris A-4 Letër
2. **Shpenzimet për antarsim dhe rilicencim në OMK & OIK (15 profesionistë shëndetësorë)**
3. **Pajisje të imëta speciale mjekësore (<1000€):** EKG min. 1 copë, Set I mjeteve të imëta pune për stomatologun), Tensiometer min 5 copë, Glikometër min 2 copë, Pulsoksimetër min 5 copë)
4. **Furnizimet për nevojat mjekësore :** Material shpenzues mjekësorë: terapinë e terrenit, si fasha modele të ndryshme, setin mikrokirurgjik, kateter urinar, ampulla si furosemid, diazepam, gentamicin, mikroklizma diazepam 5mg 2.5ml, Sistema për infuzion, Shiringa 5ml, , diclofen, nacl,glukoz, jod, kanilla 24G dhe 22G etj.
5. **Qanta për teren** min 3 copë
6. **Furnizimet për veshmbathje (Uniforma)** për stafin profesional (min. 15 copë)
7. **Kompjuter**, min. 1 copë
8. **USG:** min 1 copë
9. **Karrigë stomatologjike** min. 1 copë
10. **Automjet-Veturë (me 5 ulëse)** min. 1 copë, vetura duhet të jetë e regjistruar në emrin e kompanisë e cila shërben për ekipet mjekësore për implementimin e projektit në teren.

Për gjithë këto produkte, pajisje dhe mjete OE duhet të ofroj planin e furnizimit, sasia dhe inf. tjera.



Metodologjia

Projekti do të menaxhohet në mënyrë direkte nga QKMF me pelqim të DSHMS Drenas, si dhe do të mbikqyret dhe do të përcjelllet nga afër e tërë veprimtaria e kuadrit të punësuar në kete projekt në mënyre qe të veprojnë në bazë të planit të veprimit, ligjeve aktuale ne fuqi si dhe sipas orareve të vendosura nga institucionet komunale të KPSH-QKMF “Dr Hafir Shala” Drenas. Shërbimet dhe aktivitetet kryesore do të implementohen ne QKMF dhe ne institucione tjera relevante me aktivitetet.

Objektivat e projektit:

- Sigurimi i stafit të licencuar dhe te pregatitur për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të QKMF për menaxhimin sa me te mire te shërbimeve qe ofrohen ne kuadër te planit IKKPSH, të rasteve shtepiake duke pasë për bazë tolerancën e aspektit kohore per marrjen e shërbimeve shendetesore kualitative.
- Mirëmbajtja dhe avancimi i shërbimeve të shëndetit publik në kuadër të QKMF (trajnimi i stafit, përpunimi i kontaktit, mirëmbajtja e sistemit të regjistrimit dhe raportimit;
- Ofrimi i asistencës teknike për ofrimin e shërbimeve te ngjajshme

ZBATIMI I PROJEKTIT-Monitorimi dhe Evaluimi

OE do t'i ofrojë KPSH Drenas përmes QKMF-së shërbimet mjekesore sipas skemes se nevojave te paraqitur nga DSHMS-QKMF-së angazhimin e 17 punetorve me orar të caktuar (40 orë në javë), i cili perpilohet dhe menaxhohet nga Menaxheri i projektit ne kuader te QKMF në bashkëpunim me OE, te cilet do ta kenë përshkrimin punës dhe kontratën e cila e obligon atë për ofrimin e shërbimeve si dhe bashkëpunimin me stafin përgjegjes të rregullt të QKMF-së/DSHMS. Stafit i angazhuar do te ndahet ne disa grupe, do të jetë përgjegjës për mbulimin e sherbimeve qe kerkon QKMF-ja / DSHMS si dhe menaxhimin e rasteve ne shtepi respektivisht trajtimin, përcjelljen e trajtimit të pacientit, regjistrimin edhe raportimin e tyre.


Stafit do të monitorohen nga ana e stafit menaxhues të OE, për punën e tyre të ofruar, si dhe ata do të përpilojë raportin në baza 3, 6, 9 dhe 12 mujore për punën e tyre.

Paga e punëtorve do te jete bruto ne ofertë duke u bazuar ne Koeficientët për Paga dhe Shtesa të caktuara nga MSH hde shtesa në shëndetësi.

- Shërbimet e kujdesit shëndetësor shtëpiak dhe ambulator të ofruara nga mjek të përgjithshëm , si vizitë mjekësore , do të përfshijnë:

Vizitë mjekësore,marrja e anamnezës,shikimi i dokumentacionit mjekësor si ekzistues të pacientit, ekzaminimi i pacientit, ultrasonografia, matja e tensionit arterial dhe parametrave të tjera vital, përcaktimi i diagnozës, vendosja e planit të mjekimit, përcjellja e gjendjes shëndetësore të pacientit dhe sipas nevojës udhëzimi për kujdes në nivelin dytësorë dhe tretësorë.






- Shërbimet infermierore të kujdesit shëndetësor shtëpiak do të përfshijnë : Përgaditja e pacientit për vizitë mjekësore , matja e shenjave vitale , aplikimi i terapisë orale , dhe parenterale , pastrimi dhe lidhja e plageve , vendosja dhe ndërrimi i kateterëve urinar, oksigjenoterapia , edukimi shëndetësor,ushtrimet pasive dhe aktive si preventivë për dekubite , dokumentimi etj
- Shërbime infermierore ambulatore te pacientet , sipas përshkrimit ne seksionin III (përshkrimi i shërbimit),brenda periudhës së kontraktuar,dhënja injeksioni,vendosje infuzioni,vendosja e kateterit. pastrim plage,trajtim dekubiti, etj.
- Marja e gjakut për analiza,ruajta dhe transporti deri në laborator , përpunimi i tyre dhe dorëzimi i rezultateve, për personat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut.
- Shërbime psiko-sociale dhe seanca psiko-sociale për personat në nevojë, qofshin të moshuar apo fëmijë,siq është takime konsultative.shërbime profesionale,trajtime.etj.
- Shërbimet sociale do të përfshijnë: Përmirësim i kushteve jetësore në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm , duke ndihmuar mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit të brendshëm të shtëpisë tek personat e moshuar të vetmuar pa përkujdes familjar. Mundësi për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet shoqërore përmes kontaktit me ta.
- Shpenzimet operative do të përfshijnë : Mjetet e punës: (Pajisjet elementare mjekësore Tensiometer, Ultrasonografi kolordoplera, stetoskop, termometer, otoskop, aftalmoskop, pulsoximeter, karrikë stomatologjike, Kompjuter, Qanta për stafin, Uniforma, pastaj materialet elementare mjekësore (barëra e materiale shpenzuese mjekësore), material higjienik, shpenzime administrative te operatorit per implementim te projektit. Trajnimet e rregullta për stafin ne kuadër të programit Kujdesi i Vazhdueshëm Profesional , i cili është si kusht për rilicencim. , Automjet-Veturë (me 5 ulëse) për ekipet ne teren). Blerja e Vetures do te jetë obligim i OE. Pronar i Veturës është OE i cili duhet të merr përsipër regjistrimn çdo vit dhe mirembajtja, e furnizimi me karborante .

Rezultatet e pritura

- Qytetarët e komunës së Drenasit dhe zonave rurale do te kenë mundësi mjekimi shumë më të mirë.
- Rastet e ndryshme shëndetësore do të kenë një mundësi reale të parandalimit të shumë sëmundjeve tjera
- Do t'ju ofrohet një mundësi personave të sëmurë që mjekimin ta bëjnë pa ndonjë sakrificë të madhe në udhëtim.
- Do t'ju ofrohet një asistencë sociale dhe shëndetësore në bazë të standardeve dhe kushteve të parapara me ligj.
- Do të kemi një përmirësim të kushteve jetësore dhe një shëndet më të mire për të gjithë banorët e komunës së Drenasit.
- Përmirësimi i nivelit të standardeve jetësore për qytetarët.
- Shërbime shendetesore 24 oreshe ne dy (2) QMF / QKMF-së Drenas dhe Komoran.
- Aktivitete sociale dhe psiko-sociale te profesionalizuara
- Shërbime te veçanta geriatrike per rastet e vetmuara qe nuk mund te pregatisin vetushqimin dhe te mirembajtjen higjienen. dhe shërbimet e Kujdesit paliativ.



Përfituesit e projektit

Përfitues të projektit do të jenë:

Të gjithë qytetaret e komunës së Drenasit pa dallime,
Personat që kanë nevojë për asistencë sociale dhe shëndetësore
Drejtoria për Shëndetësi në nivel Komunal.

Stafi kompetent i OE në fund të vitit do të përpilojë raportin vjetor të shërbimeve të realizuara si dhe raportin financiar dhe do të dorëzohen QKMF-së/DSHMS dhe pas çdo raporti vjetor. QKMF-ja/DSHMS do të shkruaj letren e vlersimit për OE.

OE do të facilitojë dhe fuqizojë integrimin e mëtuajtshëm të shërbimeve në kuadër të mbrojtjes parësore në kuadër të politikave të DSHMS.

1. Dr Florije Hoxha _____
2. Dr Avni Kastrati _____
3. Ardita Leku _____